

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 1 nga 26</i>

KODI I RRJETIT - PËRCAKTIMI I TERMAVE

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri i Kompanisë	KOSTT	KOSTT	ZRrE
Data	22.11.2010	09.12.2010	10.09.2010

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe2 nga 26</i>

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	2
2	Termet e Përcaktuar	3
3	Burimet dhe Dokumentet	24

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe2 nga 26</i>

Kapitulli 2: Përcaktimi i termave

1 Hyrje

- 1.1.1.1 Ky dokument përmban termat e përcaktuara në **Kodin e Rrjetit**. Termat në **Kodin e Rrjetit** që janë me shkronja të theksuara janë termat e përcaktuara dhe duhet të interpretohen sipas listës së përkufizimeve në këtë kapitull. Një fjalë që formon plotësisht apo pjesërisht një term të përcaktuar dhe që nuk është me shkrim të theksuar nuk do të trajtohet si term i përcaktuar. Aty ku lista e përkufizimeve i referohet ndonjë fjale apo termi që është përkufizuar veçanërisht në një seksion të **Kodit të Rrjetit**, atëherë përkufizimi në atë seksion të **Kodit të Rrjetit** do të jetë mbizotërues në listën e përkufizimeve në rast të ndonjë mospërputhje.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 26</i>

2 Termat e Përcaktuar

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Energjia Aktive		Wh kWh MWh	Një matje e fluksit të energjisë elektrike, që është integrali i kohës së produktit të tensionit dhe komponentës së rrymës në fazë nëpër një pikë kyçe , e shprehur në Watorë dhe shumëfishat e tij.
Fuqia Aktive		W, kW, MW	Shkalla me të cilën transferohet energji aktive .
Kapaciteti Paraprakisht i Caktuar	AAC		Sasia totale e të drejtave të ndara për transmision, qofshin ato kapacitete apo programe shkëmbimi varësisht nga metoda e caktimit.
Shërbim Ndhimës			Një shërbim i kërkuar për operim të sigurt të një sistemi të energjisë elektrike përfshirë rregullimin e frekuencës, mbështetjen e tensionit, sigurimin e stabilimenteve gjeneruese rezervë dhe startimin nga zero (errësira) .
Marrëveshja e Shërbimeve Ndhimëse	ASA		Një marrëveshje dypalëshe ndërmjet OSTT dhe një përdoruesi për të siguruar një shërbim ndihmës .
Ofruesi (Siguruesi) i Shërbimeve Ndhimëse	ASP		Një organizatë që ofron shërbime ndihmëse për OSTT .
Orari i Miratuar			Një orar që i është paraqitur dhe është miratuar nga OSTT dhe aplikohet për orarin e ditës korresponduese dhe është i detyrueshëm për palën që e paraqet.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Gabimi i Zonës Kontrolluese	ACE		Diferenca momentale ndërmjet vlerës aktuale dhe asaj të referencës (vlera totale e matur e energjisë dhe programi i përcaktuar kontrollues) për shkëmbimin e energjisë së një zone kontrolli (devijimi i paqëllimshëm) , duke marrë parasysh ndikimin e një shmangie të frekuencës për atë zonë kontrolli sipas karakteristikave të fuqi- frekuencës së rrjetit të asaj zone kontrolli dhe devijimit të përgjithshëm të frekuencës.
Rregullimi Automatik i Gjenerimit	AGC		Një mjet nëpërmjet të cilit prodhimi i një njësie gjeneruese mund të ndryshojë në përgjigje të sinjaleve të gjeneruara direkt nga Operatori i Sistemit .
Kapaciteti Transferues në Dispozicion	ATC		Një matje e aftësisë transferuese të mbetur në rrjetin fizik të transmisionit për aktivitete të mëtejshme komerciale për dhe mbi përdorime të zotuarra paraprakisht. Kapaciteti Transferues në Dispozicion (ATC) është pjesë e NTC që mbetet në dispozicion pas secilës fazë të procedurës së ndarjes për aktivitete të mëtejshme komerciale. ATC përcaktohet nga ekuacioni si më poshtë: $ATC = NTC - AAC$
AVR			Një rregullator automatik i tensionit – një sistem i vazhdueshëm automatik ngacmimi në funksionim për të rregulluar tensionin në bornat të një njësie gjeneruese (prodhuese) .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kodi Balancues			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që mbulon aktivitetet normale në kohë reale të Operatorit të Sistemit .
Mekanizmi Balancues			Një mekanizëm i vënë në funksionim nga OSTT nëpërmjet të cilit pranohen ofertat për ngritje dhe zbritje të prodhimit në mënyrë që të arrihet ekuilibri fizik i Sistemit të Transmisionit .
Pjesëmarrësi i Mekanizmit Balancues			Një palë që merr pjesë në mekanizmin balancues .
Njësia Balancuese			Një njësi prodhuese apo ndonjë pjesëmarrës tjetër fizik i aftë për të postuar oferta tenderi në mekanizmin balancues .
Ofertë			Një ofertë nga një palë tregtare, që deklaron çmimin në të cilin ajo do ta reduktojë nivelin e gjenerimit ose livrimin përmes një interkoneksioni (ose do ta rrisë marrjen) nëse udhëzohet që ta bëjë këtë nga operatori i sistemit nëpërmjet pranimit të ofertës.
Rrënje e sistemit elektro-energjetik			Një defekt i përgjithshëm i sistemit energjetik që mbulon pjesërisht apo plotësisht sistemin energjetik.
Startimi nga errësira (zero)			Procesi i kthimit në gjendjen e mëparshme të sistemit energjetik pas një defekti të përgjithshëm apo të pjesshëm dhe ku nuk ka në dispozicion një furnizim të jashtëm me energji elektrike.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Njësia Prodhuese e Startimit nga Errësira (zero)			Një njësi prodhuese që është në gjendje të kyçet apo të jetë në funksionim pa burimin normal të jashtëm të energjisë dhe kështu ka aftësitë për të riaktivizuar sistemin energjetik pas një rënje.
Plani i Startimit nga Errësira			Plani i përgatitur dhe azhurnuar rregullisht nga OSTT për restaurimin e sistemit energjetik në rast të një rënje totale ose të pjesshme .
Kyçja			Interkoneksioni i dy sistemeve brenda Kosovës.
Marrëveshja e Kyçjes	MK		Një marrëveshje dypalëshe ndërmjet OSTT dhe një përdoruesi që detajon kushtet për kyçje me Sistemin e Transmisionit .
Pikë e Kyçjes			Pika e dakorduar për furnizimin e vendosur ndërmjet OSTT dhe një përdoruesi
Kodi i Kyçjes			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që drejton kyçjet në Sistemin e Transmisionit .
Kodi i Planifikimit të Rasteve të Paparashikuara			Kod brenda kodit operativ që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me masat që duhen ndërmarrë për të parandaluar dhe vënë nën kontroll probleme madhore të sistemit.
Plani i Qendrës së Kontrollit (Qendrës Dispeçerike) të Krizave			Një plan i përgatitur dhe mirëmbajtur nga OSTT që detajon hapat që duhen ndërmarrë në rast se qendra e kontrollit bëhet e papërdorshme.
Dita e Dispeçimit Fizik			I referohet ditës në të cilën centrali elektrik dispeçohet për të balancuar sistemin në kohë reale.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
E vdekur			Në këtë kontekst “e vdekur” do të thotë e izoluar nga të gjitha kyçjet me ndonjë sistem elektrik përfshi Sistemin e Transmisionit, sistemet dhe pajisjet e përdoruesve të tjerë.
Plani i Mbrojtjes			Një plan i përgatitur dhe i azhuruar nga OSTT që detajon masat e përdorura për të siguruar me sa është e mundur funksionimin paralel të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit energjetik të Kosovës.
Term i Përcaktuar			Një term, ose shprehje që ka një kuptim specifik. Këta terma janë me shkronja të theksuara në një dokument dhe të listuara dhe të përkufizuara në këtë Përkufizim të Termave.
Ngarkesa			Ngarkesa është shkalla me të cilën energjia elektrike e shpërndarë në apo prej një sistemi apo një pjese të sistemit, e shprehur në MW dhe MVA _r (d.m.th. fuqi aktive dhe fuqi reaktive).
Rregullimi i Ngarkesës			Procedurat që mund të përdoren për të reduktuar ose rritur në mënyrë të veçantë ngarkesën kur ka një mospërputhje serioze ndërmjet gjenerimit dhe ngarkesës në të gjithë apo në pjesë të sistemit të përgjithshëm .
Kodi i Rregullimit të Ngarkesës			Seksioni i kodit operativ që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e ngarkesës së sistemit .
Parashikimi i Ngarkesës			Një përlllogaritje e kërkesave për energji aktive/fuqi dhe energji/fuqi reaktive përgatitur nga OSTT në intervale të rregullta.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Konsumatori			Një person apo organizatë të cilit/ës i sigurohet vetëm energji elektrike.
Përrjashtim nga Dispozita			Një përrjashtim i lejuar nga rregulli – normalisht për një periudhë të caktuar kohore – që lejohet një pale të të vazhdojë operimin normal edhe pse është e paaftë të plotësojë të gjitha kërkesat kodit të rrjetit .
Dispeçimi			Procesi i lëshimit të udhëzimeve direkte për njësitë prodhuese nga OSTT .
Udhëzimet e Dispeçingut			Udhëzimet e dhëna nga OSTT për përdoruesit që lejon që funksioni i dispeçingut të zbatohet .
Njësia e Dispeçimit			Një njësi prodhuese (gjeneruese) ose një konsumator që bëhet objekt i udhëzimeve të dispeçingut të dhëna nga OSTT .
Kodi i Dispeçimit			Një seksion i kodit të balancit që mbulon përgjegjësitë e operatorit të sistemit dhe palëve të tjera në balancimin e sistemit në kohë reale.
Operatori i Sistemit Shpërndarës	DSO		Një kompani që është përgjegjëse për funksionimin, mirëmbajtjen, dhe zhvillimin e rrjetit distributiv dhe interkoneksionet e tij me rrjete të tjera distributive dhe Sistemin e Transmisionit .
Parametrat e Dispeçimit Dinamik	DDP		Karakteristikat fizike të njësive prodhuese (gjeneruese) (dhe disa konsumatorëve të mëdhenj) që e informojnë OSTT se si mund të ndryshojnë prodhimi në njësinë prodhuese (gjeneruese) relevante (ose të njësive shpenzuese).

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Tokëzimi			Procesi i sigurimit të një lidhje të kyçjes ndërmjet një përcjellësi (përçuesi) dhe tokës duke përdorur një pajisje tokëzimi të miratuar.
Pajisje Tokëzimi			Një pajisje e fiksuar apo portative për sigurimin e një kyçjeje mes një përcjellësi (përçuesi) dhe tokës.
Tregu i Energjisë Elektrike			Aranzhimet tregtare komerciale të energjisë elektrike në Kosovë në përputhje me Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike.
Kodi i Standardeve të Energjisë Elektrike			Një dokument që specifikon ndërmjet të tjerave standardet e frekuencës dhe tensionit me të cilat punohet në Sistemin Energjetik të Kosovës.
Ndodhi/Ngjarje			Një ndodhi e paplanifikuar apo e papërcaktuar (megjithëse mund të jetë parashikuar) në një sistem që përfshin pa kufizuar përshkrimin e përgjithshëm, defektet, incidentet dhe shkatërrimet.
Programi i Shkëmbimit			Shkëmbimi i përgjithshëm i energjisë së caktuar ndërmjet dy TSO-ve, zonave të kontrollit apo Bloqeve të Kontrollit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Oraret e Shkëmbimit			Një shkëmbim me marrëveshje në lidhje me madhësinë, (MW), kohët e fillimit dhe të përfundimit, periudhën e shkallshmërisë (modulimit) dhe tipin (p.sh. qëndrueshmëria); që është i nevojshëm për livrimin dhe marrjen e fuqisë dhe energjisë ndërmjet palëve kontraktuese dhe TSO-ve, ndërmjet TSO-ve dhe Zonave të rregullimit, ose ndërmjet zonave rregulluese dhe blloqeve rregulluese të përfshira në shkëmbim.
Palë e Jashtme e Kyçur			Një TSO që operon një kyçje të përbashkët me OSTT .
Kodi i Rregullimit të Frekuencës			Seksioni i kodit të balancit që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me rregullimin e frekuencës në sistemin energjetik të Kosovës
Devijim i Frekuencës			Një shmangie e frekuencës aktuale të sistemit nga vlera e frekuencës së vendosur.
Kodi i Kushteve të Përgjithshme			Kapitull i Kodit të Rrjetit që përcakton aranzhimet për adresimin e mosmarrëveshjeve, përjashtimeve (pezullimeve) nga dispozitat dhe azhurnimeve të kodit etj.
Njësia Prodhuese (Gjeneruese)			Një pjesë e veçantë e aparatit që gjeneron energji elektrike.
Njësi Transformatorike e Gjenerimit			Një transformator i lidhur direkt me daljen e një njësie prodhuese (gjeneruese) që furnizon pjesët ndihmëse të njesisë prodhuese .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Gjenerimi			Aktivitetet që i përkasin gjeneratorit përfshirë prodhimin e energjisë elektrike dhe dhënien (dërgimin) e saj në sistemin e energjisë elektrike .
Gjeneruesi			Nje person apo kompani që ndërmerr aktivitetin e zotërimit, kontrollimit ose funksionimit të njësive prodhuese (gjeneruese) dhe që gjeneron energji elektrike sipas Licencës të tij.
Koordinator i Zbatimit të Sigurisë			Një koordinator i sigurisë që zbaton masat paraprake të sigurisë për zbatimin e koordinimit të sigurisë ndërmjet sistemeve.
Formulari i Sigurisë Ndërmjet Sistemeve			Një regjistrim i shkruar i masave paraprake të sigurisë ndërmjet sistemeve i përpiluar në përputhje me rregullat e koordinimit të sigurisë (brenda rregullave të rrjetit)
Pala e Interkonektuar			Shikoni Palë e jashtme e kyçur
Interkonekzioni			Një kyçje ndërmjet dy ose më tepër TSO-ve, Zonave të Kontrollit ose Blloqeve të Kontrollit.
Marrëveshja e Interkonekcionit			Një marrëveshje dypalëshe mes OSTT dhe një shteti të interkonektuar që detajon aranzhimet teknike dhe operationale të kyçjes
Sistemi i Pavarur i Transmisionit, Operatori i Sistemit dhe i Tregut	OSTT		Një organizatë monopol (aktualisht OSTT) që zotëron dhe menaxhon Sistemin e Transmisionit , operon sistemin e transmisionit si Operator Sistemi dhe lehtëson tregun e energjisë elektrike si operator tregu të gjitha në një mënyrë jo-diskriminuese.
Izolimi			Procesi i arritjes së ndarjes galvanike të rrymës së një përçuesi nga pjesa tjetër e sistemit .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Incident i Përbashkët i Sistemit			Një ndodhi në sistemin e një pale që ka pasur ose mund të ketë pasur një ndikimi serioz dhe/ose të gjerë mbi sistemin e një pale tjetër.
Qendra e Incidentit të Përbashkët të Sistemit			Një qendër e ngritur nga OSTT në mënyrë që të mbikqyrë një incident të përbashkët të sistemit dhe të përballlet me të gjitha pyetjet në lidhje me të.
Sistemi Elektro-energjetik Kosovar			E gjithë infrastruktura e sistemeve të energjisë elektrike, gjeneratorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të lidhur në rrjetë.
Ngarkesa			Fuqia aktive, fuqia reaktive , ose fuqia e dukshme, sipas kontekstit, që gjenerohet, transmetohet, apo shpërndahet.
Parashikimi i Kërkesës së Tregut			Një vlerësim i kërkesave për energji aktive bazuar në kontratat dypalëshe të dakorduara mes pjesëmarrësve në treg .
Operatori i Tregut			Departamenti brenda OSTT që është i licencuar nga Rregullatori dhe i autorizuar për të ndërmarrë të gjitha funksionet e përshkruara për të në rregullat e tregut .
Pjesëmarrësi në Treg			Një person fizik apo juridik që operon ose furnizohet nga sistemi energjetik i Kosovës.
Rregullat e Tregut			Legjislacioni përkatës dytësor i sektorit energjisë elektrike në Kosovë që përcakton strukturën e tregut të energjisë elektrike.
Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut			Një marrëveshje në formën e përcaktuar në rregullat e tregut nëpërmjet të cilës palët nënshkruese dakordohen t'iu binden rregullave të tregut .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Instalimet Matëse			Pajisjet e nevojshme për matje që ndodhen ndërmjet pikës së matjes dhe pikës së kyçjes me rrjetin .
Rrjeti			Sistemi energjetik i transmisionit dhe/ose shpërndarjes.
Pengesë në Sistem			Një pengesë brenda Sistemit të Transmisionit që kufizon sasinë e energjisë që mund të transmetohet mes palëve të rrjetit për shkak të shkeljes së kufijve termik, të tensionit apo stabilitetit.
Humbjet në rrjetë			Humbjet e përgjithshme të energjisë elektrike në rrjetin përkatës të energjisë elektrike. Humbjet në rrjetë zakonisht konsiderohen ndaras për rrjetin e transmisionit dhe për rrjetin e distribuimit.(shpërndarjes)
Kriteri 'n-1'			Një rregull sipas së cilës elementet e mbetur në funksionim pas defektit të një elementi të vetëm të rrjetit (si p.sh. një linjë transmisioni/transformator apo njësi prodhuese, ose në disa raste një zbarë) duhet të jenë të aftë të përshtaten me ndryshimet e rrjedhës në rrjetë të shkaktuara nga një defekt i vetëm.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Neto Kapaciteti i Transferimit	NTC		<p>Neto Kapaciteti i Transferimit përkufizohet si:</p> $NTC = TTC - TRM$ <p>NTC është programi i shkëmbimit maksimal të përgjithshëm ndërmjet dy TSO-ve (Zonave të rregullimit) të afërta në pajtueshmëri me standardet e aplikueshme të sigurisë në interkoneksion duke pasur parasysh të gjitha pasiguritë në konditat e ardhshme të sistemit.</p>
Oferta			<p>Një ofertë nga një palë tregtare, që përcakton çmimin në të cilin ajo do të rrisë nivelin e gjenerimit (prodhimit) ose dërgesën përmes një interkonektori (ose do të reduktojë ngarkesën) nëse udhëzohet që ta bëjë këtë nga operatori i sistemit nëpërmjet pranimit të ofertës.</p>
Kufiri i Funkionimit (Margjina e Operimit)			<p>Prodhimi shtesë i gjenerimit – mbi atë të kërkuar për të përmbushur kërkesën – që kërkohet për të ofruar mbulimin dhe rezervimin e frekuencës në kohë reale të devijimeve të frekuencës në mënyrë që të realizohet siguria e sistemit.</p>
Funksionimi/Operimi			<p>Një veprim i planifikuar në lidhje me operimin e një sistemi.</p>
Kodi i Planifikimit Operativ			<p>Kapitull i Kodit të Rrjetit që merret me çështjet e planifikimit operativ në afatin e shkurtër.</p>

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kodi Operativ			Kapitulli Kodit të Rrjetit që merret me çështjet operative, si ato që kryhen në baza të rregullta edhe ato që vijnë si rezultat i ngjarjeve të jashtëzakonshme.
Ndërprerje			Heqja e planifikuar apo e paplanifikuar nga gatishmëria e shërbimit të një elementi të impiantit dhe/ose aparatit .
Kodi i Planifikimit të Ndërprerjeve			Seksion i kodit operativ që mbikëqyr njoftimin dhe miratimin e ndërprerjeve në sistemin e transmisionit .
Rënie e Pjesëshme			Një defekt i përgjithshëm në furnizimin me energji elektrike në një pjesë të madhe të sistemit energjetik të ndërlikur.
Palë			Dikush që operon në sistemin energjetik të Kosovës.
Njoftimi Fizik	PN		Njoftimi i dhënë nga pala tregtare për operatorin e sistemit që specifikon dërgesën ose zvogëlon ngarkesën e synuar të MW gjatë një dite të specifikuar.
Kodi i Planifikimit			Seksioni i Kodit të Rrjetit që mbikëqyr planifikimin e Sistemit të Transmisionit .
Stabilimenti dhe Aparaturat			Të gjitha pjesët e palëvizshme dhe të lëvizshme të pajisjeve ku përdoren përçuesit elektrikë, të mbështetura apo që formojnë një pjesë të tyre.
Ishull Energjisë Elektrike			Një pjesë e izoluar e sistemit të përgjithshëm ku ekziston një situatë e qëndrueshme me prodhimin e njësive prodhuese (gjeneruese) lokale që përputhet me kërkesën lokale shtesë.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Linjë elektrike si bartëse e informatave	PLC		Një sistem ku sinjalet e telekomunikimit janë të mbivendosura në linjat e transmisionit sipër tyre.
Central Elektrik			Një instalim që përfshin një ose më tepër njësi prodhuese (gjeneruese) .
Rregullim Primar			Funksioni automatik i decentralizuar i rregullatorit automatik të shpejtësisë së turbinës për të rregulluar prodhimin e gjeneratorit të një njësie si rezultat i një devijimi të frekuencës .
Rezerva e Rregullimit Primar			Rezerva e kontraktuar/planifikuar e gjenerimit që ofrohet automatikisht dhe menjëherë nga njësitë prodhuese (gjeneruese) në mënyrë që të korrektohen devijimet e frekuencës nga frekuenca e planifikuar.
Konsumator Prioritar			Një konsumator si psh. një ofruer shërbimesh kyçe në infrastrukturë, spitale etj të cilët për shkak të rëndësisë së tyre duhet të jenë objekt për trajtim të veçantë në lidhje me ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike.
Mbrojtja			Pajisjet që normalisht mbulojnë një element të vetëm në impiant që zbulon një situatë potencialisht të rrezikshme apo jonormale në sistem dhe dërgon një sinjal për ndërprerësin e qarkut në mënyrë që të ndërpresë elementin e impiantit prej sistemit.
Energjia Reaktive		VARh	Një matje, në Varorë e shkëmbimit alternativ të energjisë së rezervuar në induktor dhe kapacitor e cila është integrali kohor i prodhimit të tensionit dhe komponentës së rrymës së shfazuar në një pikë kyçese .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Fuqia Reaktive		VAr	Produkti i tensionit dhe rrymës dhe shenjës së këndit të fazës ndërmjet tyre matur në njësi VAr apo MVAR.
Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm			Një operator i një sipërmarrje elektrike që kërkon me mirëbesim të kryejë detyrimet e tij dhe, në drejtim të sipërmarrjes së tij, të ushtrojë shkallën e aftësive, kujdesit, zellit dhe parashikimit që mund të priten në mënyrë të arsyeshme nga një operator i aftë dhe me eksperiencë me burime të mjaftueshme financiare që respekton licencat përkatëse dhe Kodin e Rrjetit dhe çdo referim ndaj standardit të operatorit të arsyeshëm dhe të kujdesshëm do të jetë referim për atë shkallë zotësie, zelli, kujdesi dhe parashikimi si është thënë më lart.
Rregullatori			Zyra e Pavarur Rregullatore e Energjisë (ZRrE) e themeluar me Rregulloren nr. 2004/20 të një ligji të përshtatur nga Kuvendi i Kosovës mbi Rregullatorin e Energjisë.
Koordinatori i Kërkesave të Sigurisë			Një person që kërkon masat paraprake të sigurisë për implementimin e koordinimit të sigurisë ndërmjet sistemit.
Reduktimi i ngarkesës me Rotacion			Proceset dhe rregullimet për shkyçjen e ngarkesës në një mënyrë të përsëritur duke ndjekur një cikël të planifikuar dhe të njoftuar paraprakisht në mënyrë që të balancojë furnizimin me kërkesën .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Koordinatori i Sigurisë			Një person i cili është emëruar me shkrim nga një palë, OSTT dhe shfrytëzuesi , i cili do të jetë i autorizuar të ndër marrë izolim dhe tokëzim në pikat e kyçjes.
Menaxhimi i Sigurisë			Procesi i sigurimit që sistemi TL është në gjendje të tillë ku ndërmarrja e punimeve dhe/ose testeve është e sigurt për personelin
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë			Një sistem që përfshin proceset për çaktivizimin, izolimin , tokëzimin dhe lëshimin e dokumenteve.
Masat Paraprake të Sigurisë			Kryerja e një ose të dyjave veprimeve të mëposhtme – izolimi dhe tokëzimi .
Rregullat e Sigurisë			Rregullat e detyrueshme të OSTT ose një përdoruesi që përpiqen të sigurojnë se personat që punojnë në impiant dhe/ose aparat për të cilin aplikohen rregullat janë të sigurt nga rreziqet që lindin nga sistemi .
SCADA			Një shkurtesë për Kontroll Mbikëqyrës dhe Mbledhje të Dhënash, sistemi kompjuterik në kohë reale që përdoret për të monitoruar dhe kontrolluar Sistemin e Transmisionit në kohë reale.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rregullimi Sekondar			<p>Një funksion automatik i centralizuar për të rregulluar gjenerimin në një zonë kontrolli bazuar në rezervat sekondare të rregullimit për</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbajtur rrjedhjen e shkëmbimit të energjisë në programin e kontrollit me të gjitha zonat e tjera (dhe të korrektojë humbjen e kapacitetit në një zonë kontrolli të ndikuar nga një humbje në prodhim) dhe, në të njëjtën kohë, - (në rast të një devijimi madhor në frekuencë që e ka prejardhjen nga zona e kontrollit, veçanërisht pas humbjes së një njësie prodhuese të madhe) për të rivendosur frekuencën në rast të një devijimi në frekuencë që e ka prejardhjen nga zona e kontrollit për vlerat e saj të vendosura në mënyrë që të lirojë kapacitetin e angazhuar nga rregullimi primar (dhe për të rivendosur rezervat e rregullimit primar)
Rezerva e rregullimit Sekondar			<p>Rezerva që krijohet automatikisht nga njësitë prodhuese për të kontrolluar rrjedhat e ngarkesës dhe të frekuencës si për funksionimin normal ashtu edhe pas një pasigurie madhore. Mund të ofrohet si nga njësitë prodhuese edhe nga shkëputja me ndërprerje të ngarkesës.</p>
Incident i madh			<p>Një ndodhi/ngjarje të cilën OSTT ose një shfrytëzues e konsideron se ka pasur ose mund të ketë një ndikim të madh mbi sistemin e transmisionit.</p>

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Dokumentet Standarde			Dokumentet që janë aktualisht në përdorim nga OSTT që përcaktojnë të gjitha specifikimet, standardet dhe procedurat teknike, të dizajnit, të planifikimit, të ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe të funksionimit që aplikohen për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të Sistemit të Transmisionit dhe të impianteve energjetike . Këto dokumente do të azhurohen kohë pas kohe.
Paraqitje/Dorëzim			Informacioni mbi dërgesën dhe zbritjen e planifikuar të energjisë elektrike që i ofrohet Operatorit të Sistemit nga një palë tregtare .
Furnizuesi			Një person ose organizatë që blenë dhe shet energji elektrike.
SVC			Një kompensator var statik. Një pajisje statike që përdoret për të kontrolluar tensionin e sistemit duke ofruar energji reaktive .
Udhëzimi i Kyçjes			Funksionimi i impiantit dhe/ose aparatit sipas udhëzimit të OSTT ose një shfrytëzuesi .
Sistem			OSTT ose ndonjë shfrytëzues i sistemit sipas rastit.
Kufizimi i Sistemit			Kërkesa për të siguruar rezervë duke kufizuar prodhimin e njesisë gjeneruese
Operatori i Sistemit			Departamenti brenda OSTT që është përgjegjës për operimin e Sistemit të Transmisionit përfshi dispeçingun ekonomik, sigurinë dhe cilësinë e furnizimit në Sistemin e Transmisionit .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Testimi i Sistemit			Një testim i cili kur kryhet në një sistem energjetik do të ketë ose mund të ketë një efekt të rëndësishëm.
Rregullimi Terciar			Çdo ndryshim automatik apo manual në pikat e punës së gjeneratorit (kryesisht duke ri-planifikuar) ose reduktimi i ngarkesës që duhet të lëshohet brenda 15 minutash sipas udhëzimit përkatës të dispeçingut.
Rezerva e Rregullimit Terciar			Rezervë e koordinuar nga qendra që ofrohet manualisht për të zëvendësuar rezervën e rregullimit sekondar pas një rasti pasigurie.
Kërkesa Totale			Kërkesa totale e MW të energjisë elektrike për tërë sistemin energjetik të Kosovës.
Çkyçje Totale			Situata që ekziston kur i gjithë gjenerimi ka pushuar dhe nuk ka energji elektrike për furnizim dhe për këtë arsye sistemi energjetik të Kosovës ka pësuar një shkyçje. Për të ristartuar sistemin energjetik duhet një startim nga errësira .
Sistemi i Përgjithshëm			Entiteti total i integruar që përfshin sistemin energjetik të Kosovës.
Kapaciteti i Përgjithshëm i Transferimit	TTC		Programi maksimal i shkëmbimit ndërmjet dy TSO-ve (zonave të rregullimit) fqinje që përputhet me standardet e sigurisë së funksionimit të aplikuara në secilin sistem (p.sh. kodi i rrjetit) nëse kushtet e rrjetit, gjenerimit dhe strukturave të ngarkesës janë saktë paraprakisht të njohura.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Palë Tregtare			Një gjenerues, furnizues, tregtar interkonektor ose palë tjetër që ka pranuar rregullat e tregut në mënyrë që të tregtojë energji elektrike ose kapacitet.
Transmisioni			Aktivitetet që kanë lidhje me rrjetin e transmisionit përfshirë transportimin e energjisë elektrike, dhe ofrimin e lidhjes fizike me të.
Kufizimi në Transmision			Situata ku qëndrueshmëria termike, tensioni e tejkalojnë kufirin e qëndrueshmërisë së sistemit të transmisionit.
Licenca e Transmisionit			Një licencë e lëshuar nga Rregullatori për OSTT që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit në lidhje me Sistemin e Transmisionit që zotërohet, vihet në funksionim dhe mirëmbahet nga OSTT.
Sistemi i Transmisionit			Rrjeti i energjisë elektrike në zotërim të OSTT.
Plani i Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit	TNDP		Një plan që hartohet çdo vit dhe që propozon zhvillimet e ardhshme të sistemit energjetik për [10] vitet në vazhdim duke mbajtur parasysh parashikimet e kërkesës, zhvillimet e parashikuara të gjenerimit dhe heqjen e autorizimit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kufiri i Besueshmërisë së Transmisionit	TRM		<p>Një kufi i sigurisë që merret me pasiguritë në vlerat e përlogaritura të TTC që lindin prej:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Devijimeve të padëshiruara të rrjedhave fizike gjatë operimit për shkak të funksionimit fizik të rregullimit sekondar. • Shkëmbimeve të emergjencës ndërmjet TSO-ve për të përballuar situatat e paparashikuara të çekuilibrit në kohë reale. • Pasaktësive në mbledhjen dhe matjen e të dhënave.
Çkyçja			Hapja e ndërprerësit të qarkut si pasojë e drejtpërdrejtë dhe normalisht e menjëhershme e operimit të një releje apo një pajisjeje mbrojtëse.
Parashikimi i Kërkesës nga OSTT			Një vlerësim i kërkesave të energjisë aktive dhe energjisë reaktive i përgatitur nga OSTT në intervale të rregullta.
TSO			Operatori i Sistemit të Transmisionit në këtë kontekst i referohet organizatës ose organizatave në shtetet fqinje që janë përgjegjëse për operimin dhe pronësinë e sistemeve të tyre të transmisionit.
Reduktimi i Ngarkesës nga Nën-frekuenca			Shkyçja automatike e kërkesës nëpërmjet një releje matëse elektrike e menduar të operojë kur sasia karakteristike arrin në aranzhimin e relesë duke ulur frekuencën.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Devijim i Padëshirueshëm			Diferenca ndërmjet shkëmbimit aktual të energjisë që ka ndodhur në një interval të caktuar kohe (shkëmbimi i pavullnetshëm fizik i energjisë së një zone kontrolli) dhe programit të planifikuar të kontrollit të një zone kontrolli ose blloku të kontrollit), pa marrë parasysh efektin e anësisë së frekuencës, që pason shenjën.
Përdorues			Dikush i ndryshëm nga OSTT i cili përdor Sistemin e Transmisionit të Kosovës .Një OSSH është një përdorues i Sistemit të Transmisionit .
Kodi i Rregullimit të Tensionit			Seksioni i kodit operativ që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me rregullimin e tensionit në sistemin energjetik të Kosovës.

3 Burimet dhe Dokumentet

3.1 Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Ligji për Energjinë Elektrike
2.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
3.	
4.	

3.2 Dokumentet dhe formularët

3.3

3.4 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.1	27.01.2007	Është aprovuar versioni i reviduar	1 vit
2.0	14.01.2008	Edicioni 1, Rishikimi 1	2 vjet
2.1	10.09.2010	Edicioni 2	

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 25 nga 26</i>

--	--	--	--